

VENDIM
Nr.616, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE PUNONJËSVE
MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË PAVARURA”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.901, datë 19.12.2007, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - c) Shkronja “c” e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c. Paga e pozicionit “Sekretar i titullarit”, “Sekretar i organit kolegjal drejtues”, është 55 900 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind) lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionet “Sekretar i titullarit”, “Sekretar i organit kolegjal drejtues”, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.”.
 - ç) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit”, apo “Drejtorët”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse, pas miratimit rast pas rasti, nga njësitë e personelit të çdo institucioni.”.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të miratuara për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE						
KLASA	POZICIONI	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE PAGA BAZË			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4	5
			Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa e pozicionit (SHP) lekë
I	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1	2%		115 000
II	Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme	II-a	1	2%		105 000
	Drejtor drejtorie	II-b	1	2%		88 000
III	Përgjegjës sektori	III-a	1	2%		71 000
	Inspektori i auditimit të brendshëm					
	Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%		62 000
	Specialist i nivelit të lartë. Inspektor i auditimit të brendshëm	III-b	1 ose 2	2%		54 000
IV	Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%		43 000
	Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%		33 000

Lidhja nr.4

**VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR**

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefhme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë